



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:054226

Datë: 22.02.2024

Numri i dokumentit: 05359712

Rev.nr.512/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami kryetar, Zenel Leku dhe Rustem Thaqi, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. Xh. nga M., të cilin e përfaqëson me prokurë, Arbër Fazliu, avokat nga P., kundër të paditurës Telekom i Kosovës, sh.a., me seli në P., të cilën e përfaqëson me prokurë H. H., për kompensimin e përvojës së punës, shpërblimit jubilar dhe për shujta, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4141/2022 të datës 20.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 20.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pa bazuar revizioni i të autorizuarit të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4141/2022, datë 20.09.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2246/2020, të datës 03.02.2022, është vendosur në pikën I të dispozitivit të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M. Xh. nga M.. Në pikën II detyrohet e paditura Telekom i Kosovës, sh.a. me seli në

P., që paditësit t'ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 4,337.06€, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës, shumën prej 1,199.54€; përvojës së punës 0.5%, nga data 01.06.2019 deri më 30.11.2021, shumën prej 1,238.52€, dhe shujtave ditore për 633 ditë pune nga data 01.06.2019, deri me data 30.11.2021, shumën prej 1,899.00 €; Të gjitha këto me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga marrja e këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Në pikën III detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 514.00 €, në afat prej 7 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin Ac.nr.4141/2022, të datës 20.09.2023, ka refuzuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion i autorizuari i të paditurës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta pranojë si të bazuar revizionin, të prish të dy aktgjykimet e instancave më të ulta dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

Pala paditëse nuk ka paraqitur përgjigje në revizion.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 215, gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi M. Xh., nga M., më datën 19.05.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi ndaj të paditurës, si dhe me precizimin e saj ka kërkuar, që të detyrohet e paditura Telekom i Kosovës, sh.a. me seli në P.që paditësit në emër të pagës jubilarë për 10 vite përvojë pune t'ia paguajë shumën prej 1,199.54 €; në emër të përvojës së punës prej 0.5% shumën prej 1,238.52 €; në emër të kompensimit të ushqimit për 633 ditë pune nga data 01.06.2019 deri më datë 24.12.2021, t'ia paguajë shumën prej 1,899.00 € deri më datë 30.11.2021 si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve, si kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës për kohë të pacaktuar, me numër e datës 02.09.2015; lista e pagës për muajin janar, 2020 e datës

24.02.2020, lidhur me pagën mujore të paditësit; vërtetimi në emër të paditësit M. Xh. i lëshuar nga e paditura Telekom i Kosovës, sh.a., në P. me numër i datës 25.02.2020, lidhur me vitet e përvojës së punës të paditësit nga data 01.06.2007 deri më datë 25.02.2020, si dhe vërtetimi për pagën mujore të paditësit në shumë prej 1,199.54 €; vendimi i të paditurës me numër, i datës 03.04.2020, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për pagesën e një page në emër të shpërblimit jubilar; ekspertiza financiare e datës 24.12.2021, e punuar nga eksperti financiar R. S.; marrëveshja Kolektive e Punës në Telekomin e Kosovës me numër e datës 31.05.2019; si dhe Rregullorja e punës e të paditurës Telekom i Kosovës, sh.a. me numër e datës 27.11.2019, së bashku me pasqyrat financiare për vitin 2018, 2019 dhe 2020, ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të tij gjykata ka theksuar se nga provat e administruara gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura Telekom i Kosovës sh.a, në P., sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar Nr., e datës 01.09.2020, në pozitën Mbikëqyrës i kontrollit të brendshëm, në Departamentin e Financave. Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte kompensimi i shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës, shtesën prej 0.5% të pagës në emër të përvojës së punës dhe shujtave ditore për ditët e pranisë në punë.

Bazuar në nenin 44 të Marrëveshjes Kolektive të Punës në Telekomin e Kosovës nr. 01-3207/19 e dt. 31.05.2019, në bazë të cilës paditësit për 10 vite të përvojës së punës i takon vlera e një page bazë. Po ashtu me Rregulloren për marrëdhënie pune të Telekomit të Kosovës nr. 01-6352/19 e dt. 29.11.2019, me dispozitën e nenit 38 par. 7 parashikohet e drejta në shtesën për përvojën e punës prej 0.5 % të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës së punës dhe për shujta ditore, si dhe me dispozitën e nenit të njëjtit 38 par. 8 parashikohet paga jubilarë për 10 vite të përvojës së punës në lartësinë e një page të fundit të punëtorit. Gjykata gjeti se Marrëveshja Kolektive e Punës në Telekomin e Kosovës nr. 01-3207/19 e dt. 31.05.2019, dhe Rregullorja për marrëdhënie pune të Telekomit të Kosovës nr. 01-6352/19 e dt. 29.11.2019, janë të zbatueshme në rastin konkret. Në një gjendje të tillë e çështjes gjykata e aprovoi kërkesën e paditësit dhe e detyroi të paditurën që paditësit për 10 vite të përvojës së punës në emër të shpërblimit jubilar t'ia kompensoj shumën në lartësi të një page bazë në shumë prej 1,199.54 €, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Po ashtu edhe për përvojën e punës prej 0.5 % të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës së punës për periudhën nga dt. 01.06.2019 deri me dt. 30.11.2021 paditësit sipas ekspertizës financiare i takon shuma prej 1238.52€. Gjykata konstatoi se sa i përket përvojës së punës për 10 vite e paditura i ka mbetur borxh paditësit në shumë prej 1,199.54 € dhe për shtesat në emër të përvojës së punës për çdo vit nga 0.5% për periudhën 01.06.2019 deri me dt.

30.11.2021 e paditura i ka mbet borxh paditësit në shumë prej 1,238.52 € (duke qenë se sipas ekspertizës financiare paditësit për këto dy kërkesa i takon shuma prej 2,438.06€).

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën e paditësit brenda kufijve të saj, edhe në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i vëren gjykata sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera që pretendohet me ankesë, gjendja faktike është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë . Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se, pretendimet e të paditurës, lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, është pretendim i pabazuar, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave, të cilat i ka pasur në dispozicion, ka marr aktgjykimin e drejtë sa i përket njohjes së kompensimit për përvojën e punës, kompensimin e shpërblimit jubilar dhe për shujta ditore, i cili është arsyetuar tërësisht në pjesën arsyetuese të tij dhe në këtë rast sa i përket kësaj pjese, gjykata e shkallës së parë përveç fakteve të cilat kanë qenë jokontestuese ka vërtetuar faktet kontestuese, duke dhënë arsyet e duhura për çdo fakt vendimtar. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve por edhe është vërtetuar në mënyrë të plotë se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, vitin jubilar e ka arritur më datë 01.06..2017, padinë në gjykatë e ka ushtruar më datë 19.05.2020, po ashtu ditët e pranisë në punë dhe shuma prej 3.00 € në ditë dhe shuma në emër të kompensimit për përvojën e punës janë vërtetuar me ekspertizën e ekspertit përkatës, ndaj të cilës nuk kanë pasur vërejtje palët ndërgjyqëse, në rastin konkret kontestuese ka qenë baza juridike e padisë.

Gjykata e Apelit nuk i aprovoi pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, duke e arsyetuar këtë me nenin 90 parag. 1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, ku përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve ".

Gjykata e Apelit e arsyeton më tej se me nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e dt. 18/03/2014, e cila ka hyrë në fuqi me dt.01.01.2015, parashihet se "i punësuar, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij. E njëjta parashihet edhe në nenin 44 të Marrëveshja Kolektive e Punës në Telekomin e Kosovës nr. 01- 3207/19 e dt. 31.05.2019, ku thuhet se punonjësve u takon kompensimi i shtesave për përvojë pune 0.5% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës së punës. Gjykata konstaton se në kohën kur paditësi e ka fituar

kushtin për kompensimin e pagës jubilarë ka qenë në fuqi Përgjithshme Kolektive të Kosovës, dhe se padia është paraqitur brenda aftit.

Me rregulloren për marrëdhënie pune të Telekomit të Kosovës nr. 01-6352/19 e dt. 29.11.2019, me dispozitën e nenit 38 par. 7 parashikohet e drejta në shtesën për përvojën e punës prej 0.5% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës së punës dhe për shujta ditore, si dhe me dispozitën e nenit të njëjtit 38 par. 8 parashikohet paga jubilarë për 10 vite të përvojës së punës në lartësinë e një page të fundit të punëtorit.

Pretendimet e të paditurës lidhur me atë se paditësit nuk i takon shpërblimi jubilar sepse në kohën e arritjes së vitit jubilar me datë 01.6.2017, nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja kolektive e punës në Telekomin e Kosovës, e dt.31.05.2019, nuk qëndrojnë për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore në kohën e arritjes së vitit jubilar me datë 01.6.2017, ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e dt. 18.03.2014 e cila ka hyrë në fuqi me 01.01.2015, e cila e ka rregulluar pagesën e shpërblimit jubilar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave me të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara.

Në logjikën e njëjtë është edhe aktgjykimi i shkallës së dytë në të cilin paraqiten arsyet për konfirmimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së

dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm.

Në këtë kontekst me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve të instancave më të ulëta.

Për sa i përket zbatimit të së drejtës materiale, Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët kanë vepruar drejtë kur kanë aprovuar kërkesëpadinë paditësi sepse e paditura duke mos e kryer detyrimin e saj, i ka mbetur borxh paditësit për pagesën e shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës në lartësinë e një page bazë, shujtave ditore për 633 ditë pune, si dhe e drejta për përvojën e punës prej 0.5% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës së punës; andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor. Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret është obligim i të paditurës të zbatojnë marrëveshjen e brendshme të saj, pasi që e njëjta Marrëveshja Kolektive e Punës në Telekomin e Kosovës nr. 01-3207/19 e datës 31.05.2019 vet e ka nënshkruar me Sindikatën e punëtorëve, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura ti përmbushë kompensimin e shujtave ditore për 633 ditë pune, si dhe e drejta për përvojën e punës prej 0.5% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës së punës. Marrëveshja Kolektive e punës në Telekomin e Kosovës e datës 31.05.2019, ka qenë në fuqi sepse sipas nenit 4 të saj, marrëveshja ka kohëzgjatje prej 3 vjetësh dhe prodhon efekt nga data 01.06.2019 deri më 31.05.2022.

Ndërsa kur bëhet fjalë për pagën jubilarë në 10 vjetorin e punës së paditësit, kemi të bëjmë me zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se kjo marrëveshje aplikohet në periudhën kohore nga data 01.1.2015 e deri më 31.12.2017. Në rastin konkret, përfundimisht paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën më datë 01.06.2007, viti jubilar i dhjetë është më 01.06.2017, padia e paditësit është paraqitur më 19.05.2020 edhe sipas Gjykatës Supreme kërkesa ka arritur brenda afatit kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka qenë në fuqi, ndërsa padia është paraqitur brenda afatit të lejuar tre vjeçar, në kuptim të nenit 87 të Ligji Nr. 03/L-212 të Punës.

Objekt i shqyrtimit ishin edhe pretendimet e palës së paditur se e paditura është duke operuar me humbje dhe vështirësi financiare, por gjykata gjeti se pretendimet e tilla nuk janë

shkaqe të arsyeshme, të justifikueshme dhe të ligjshme për të vendosur ndryshe, ndaj dhe gjykata pretendimet e tilla i refuzoi si të pabazuara. E paditura pretendon se nuk ka buxhet për këtë lloj kompensimi sepse nuk ka mjete financiare për këtë qëllim dhe të njëjtat paguan sipas performancës pozitive financiare, prandaj kjo gjykatë vlerëson se është çështje brendshme e të paditurës dhe nuk ka ndikim në vendimin e gjykatës.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga i autorizuarit të paditësit nuk janë vlerësuar pasi që sipas dispozitës së nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.512/2023, datë 20.02.2024

Kryetari i Kolegjit
Beshir Islami